REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 336/20
Datë/Datum. 29.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës**

Nr i prokurimit	**KEK-19-250-1-1-1**
Nr i brendshëm	**KEKC-19-055-111**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas**

RI-VLERËSIM- 08.05.2020

A N K E S Ë

Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **NTSH "EKOINVEST"**

Adresa : **Rruga "Agim Ramadani", Nr. 511/9, *Prishtinë, 10 000***

Numri Telefonit/ Numri i Faks-it: **044/303-068**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Bahri Asllani**

Adresa elektronike: **info@ekoinvest.co**

Data e parashtrimit të ankesës: 29.05.2020

Nënshkrimi dhe vula:_____

Ndërmarrja Tregtare Shërbyese EKO INVEST PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. **Njoftimi për kontrate: 31.01.2019**
2. **Procesverbal i hapjes se ofertave – 18.03.2019**
3. **Njoftimi për dhënie te kontratës/vendimi i AK : 07.05.2019**
4. **Njoftimi për OE te pasuksesshëm: 07.05.2019**
5. **Kërkesë për Ri-shqyrtim 13.05.2019**
6. **Njoftimi për dhënie te kontratës/vendimi i AK : 09.08.2019**
7. **Njoftimi për OE te suksesshëm: 09.08.2019**
8. **Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit/vendimi i AK : 25.09.2019**
9. **Njoftimi për OE te eliminuar: 25.09.2019**
10. **Kërkesë për Ri-shqyrtim 30.09.2019**
11. **Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim te Kërkesës për Ri-shqyrtim: 02.10.2019**
12. **Ankesa për OSHP- 10.10.2019**
13. **Ekspertiza e Eksperteve Shqyrtues: 678-698/19 e datës 28.10.2019**
14. **Vendimi i PSH Nr. 678-698/19 i datës 22.11.2019**
15. **Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit/vendimi i AK : 14.01.2020**
16. **Njoftimi për OE te eliminuar: 14.01.2020**
17. **Kërkesë për Ri-shqyrtim 20.01.2020**
18. **Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim te Kërkesës për Ri-shqyrtim:22.01.2020**
19. **Ankesa për OSHP- 24.01.2020**
20. **Ekspertiza e Eksperteve Shqyrtues: 61/20 e datës 12.02.2020**
21. **Vendimi i PSH Nr. 61/20 i datës 26.02.2020**
22. **Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit/vendimi i AK : 08.05.2020**
23. **Njoftimi për OE te eliminuar: 08.05.2020**
24. **Kërkesë për Ri-shqyrtim 13.05.2020**
25. **Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim te Kërkesës për Ri-shqyrtim:20.05.2020**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po				Jo	X

Hapja ne mënyre elektronike- Nuk kemi marre pjese

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			Jo	

Me datën 08.05.2020 përmes Platformës se E-prokurimit kemi pranuar Vendimin e AK dhe Letrën Standarde për Tenderuesin e eliminuar.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	X	Jo	

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Me datën 13.05.2020 përmes platformës se e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës . Me datën 20.05.2020 përmes platformës se E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës, gjate Ri- vlerësimit të ofertave sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues PSH. nr. 61/20 të datës 26.02.2020, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës , Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05//L-092 dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik AO1

Shkeljet e dispozitave të LPP

Nenit 1- Qëllimi
nenit 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 59 : Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 62: Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Shkeljet e dispozitave të RRUOPP AO1

Neni 41.2- Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 08.05.2020 përmes Platformës se E-prokurimit kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e eliminuar. Ne Letrën Standarde për Tenderuesin e eliminuar si arsyeje e eliminimit shënon:

-Ne ANEKS 1 te DT ,pika 1.2.7- eshte kërkuar : Pneumatic Dot-Peen Pin Stamp Marker Station, ndërsa ne ofertën e juaj ju e keni dhënë katalogun me përshkrim teknik te Optinal Dot-Pen Marker te prodhuesit Mannesman Modeli ES 350 ER.
-Te prerja me plazme janë kërku për çeliçet e buta mundesija e prerjes prej 0,5 – 80mm; për çelicë austentike 3 – 80mm dhe për metale me ngjyrë 6-80mm ndersa sipas katalogut te prodhuesit eshte ofru vetem maksimumi i prerjes dmth. 80mm.
-Askund ne katalogun e prodhuesit nuk figurojnë standardet e kërkuara: DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100 te cilat standarde janë esenciale për këte lloji te paisjes.
- Nga prodhuesi nuk eshte cek se a garantohet lidhur me celikun e konstrukcionit per pune te rënda me ngarkesë si kërkohet ne dosje te tenderit.
- Ne specifikimin teknik te detyrushëm është kërku që prodhuesi dimenzionet e paisjes i adapton ne bazë të dhënave bazike e këtë perms katalogut nuk mund ta shofim sakt. Kjo nenkupton qe pasi qe behet fjale per nje paisje e cila nuk eshte prodhim serik por punohet sipas porosise si dhe eshte shume e shtrejt prodhuesi ose ofertuesi eshte i obliguar qe perveq katalogut te prodhimeve serike te siguroj nje skice ose vizatim tre dimensional ku ne baze te kerkeses se ofertes paraqiten paisja me repartet percjellese ku seicili repart eshte dasht te shenohet ne baze te dosjes se tenderit. Kete po e cekim pasi cdo prodhues serioz qe prodhon paisje sipas porosise ta ofron skicen trdimenzionale si do te duket paisja e porositur me te gjitha te dhenat kjo njiherit eshte edhe garancion se do ta punoj ate qe eshte kerkuar.
- Katalogu i prodhusit i ofruar është një katalog i pakompletuar ne tërsi, nuk është bërë renditja dhe nenvizimi (është i pjeserishëm) i karakteristikave teknike sipas dosjës se tenderit.

Këto arsyeje të eliminimit nuk qëndrojnë për këto fakte:

- Katalog të pajisjeve me të cilën kemi ofertuar të vërtetuara nga prodhuesi **LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S** , ashtu siç ka kërkuar edhe Autoriteti Kontraktues në nenin 9.1 &9.2 ne FDT të dosjes se tenderit. Ne katalogun që kemi dorëzuar së bashku me ofertën është edhe katalogu dhe përshkrimi teknik ku është i përcaktuar edhe modeli i **Markerit Dot-Peen Modeli ES 350 ER.** Ne se bashku me ofertën kemi dorëzuar edhe Aneksin nr. 1 Specifikat Teknike të detyrueshme te Dosjes se Tenderit e kemi nënshkruar dhe vulosura nga lideri i grupit te OE NTSH "EKOINVEST" dhe Prodhuesit **LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S** dhe Deklaratën e Përputhshmërisë se Specifikave Teknike te nenskruar dhe vulosur nga lideri i Grupit te OE, që dëshmon qe Makinë portale CNC për prerje me plazmë dhe me gas me të cilën ne kemi ofertuar është konforme specifikave teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Aneksit nr. 1 të Dosjes se Tenderit; **Dëshmia 1. Se Markeri Dot-Peen Modeli ES 350 ER dhe pajisja në tërësi i plotëson të gjitha specifikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues në vendimin PSH. nr. 61/20 i datës 26.02.2020;**

- **Konstatimi i Autoritetit Kontraktues se në katalog është ofruar vetëm maksimumi i prerjes prej 80 mm nuk munde të jete arsyeje për eliminim të ofertës për faktin së për çdo njërin që ka njohuri elementare të kësaj pajisje , kur është shënuar maksimumi prej 80 mm nënkuptohet se koka e CNC ka kapacitet prerje prej 0 mm deri 80mm.**

- **Ne asnjë vend të Dosjes se Tenderit Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar që në katalogun e prodhuesit të shënohen Standardet DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100. Bazuar në kërkesën e AK të paraqitur ne Aneksin nr. 1 te Dosjes se tenderit në së bashku me ofertën kemi dorëzuar Deklarate të nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi së Makina Portale CNC do të jete e prodhuar sipas standardeve DIN EN ISO 9013; DIN EN 28206 dhe DIN EN ISO 12100: Dëshmia 2**

- **Bazuar në dhënat e shënuara në Dosje te Tenderit , dimensionet e pajisjes janë në diskrecion të prodhuesit. Autoritetit Kontraktues vete e ka cekur se kemi të bëjmë me pajisje specifike e cila nuk është prodhim serik por prodhohet sipas porosisë dhe është shume e shtrenjte, prandaj nuk mund të jete arsyeje e eliminimit mos paraqitja e skicave apo vizatimit tredimensional të pajisjes gjate fazës se ofertimit pasi qe një kërkese e tille nuk ka qene e shënuar në Dosje te Tenderit dhe kur dihet se një pajisje e tille ende nuk është prodhuar por pritet të prodhohet sipas kërkesave të AK. Ne se bashku me ofertën kemi dorëzuar Deklarata me shkrim te nënshkruar dhe vulosur nga Prodhuesi LOY MAK Makine , (qe është edhe anëtar i konsorciumit) dhe Lideri i konsorciumit NTSH Ekoinvest së dimensionet kryesore të makinës do te zgjidhen nga prodhuesi dhe do të adaptohen në baze të të dhënave bazike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Dëshmia 3. Nëse vjen deri të nënshkrimi i kontratës ne do te bashkëpunojmë ngushte me AK gjate tere procesit të prodhimit të pajisjes dhe do të konsultohemi paraprakisht për çdo detaj duke përfshi edhe dimensionet e pajisjes.**

- **Pretendimi i** Autoritetit Kontraktues **se Katalogu i prodhuesit të cilin ne e kemi dorëzuar së bashku me ofertën nuk është i kompletuar dhe mungon renditja nuk qëndron për faktin së kemi te bëjmë me një pajisje shume specifike që nuk është prodhim serik por prodhohet sipas porosisë prandaj është e pa mundur paraqitja e të gjitha pjesëve në katalog. (ketë edhe vete** Autoritetit Kontraktues **e ka konstatuar). Shiko Dëshminë 1**
  Se katalogu të cili e kemi dorëzuar se bashku me ofertën i përmbushë kërkesat e AK e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues në vendimin PSH. nr 61/20 të datës 26.02.2020.

Te gjitha dokumentet që kemi dorëzuar së bashku me ofertën janë me së të mjaftueshme për të dëshmuar se Makina Portale me te cilën ne kemi ofertuar i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të paraqitura në Dosjen e Tenderit- Aneksi nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme.

Se oferta të cilën e kemi dorëzuar është oferte e përgjegjshme e dëshmon edhe fakti që Autoriteti Kontraktues gjate vlerësimit dhe ri-vlerësimit të ofertave tri here radhazi ofertën teknike të dorëzuar nga në, e ka konsideruar teknikisht të përgjegjshme dhe nuk na ka eliminuar për shkak të mosplotësimit të specifikave teknike.

Gjithashtu së oferta jone është oferte e përgjegjshme e dëshmojnë:

- Ekspertiza e Eksperteve shqyrtues nr. 678-698/19 e date 28.10.2019
- Vendimi i Panelit Shqyrtues , PSH. nr. 678-698/19 i datës 26.02.2020.
- Ekspertiza e Eksperteve shqyrtues nr. 61/20 e date 12.02.2020
- Vendimi i Panelit Shqyrtues , PSH. nr. 61/20 i datës 26.02.2020. Sipas këtij vendimi Eksperti Shqyrtues Teknik dhe Paneli Shqyrtues kane konstatuar se makina portale CNC e ofruar nga grupi i OE NTSH "EKOINVEST" & "LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S" i plotëson te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të paraqitura në Dosjen e Tenderit- Aneksi nr. 1- Specifikat Teknike te Detyrueshme.

Përshkrim i konkluzionit të Vendimit të Panelit Shqyrtues , PSH. nr. 61/20 i datës 26.02.2020:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues NTSH"EKOINVEST"-Prishtinë se AK Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, pika 1.2.7 ka kërkuar: Pneumatic Dot-Peen Pin Stamp Marker Station. OE N.T.SH. "EKOINVEST" – Prishtinë si bartës i konsorciumit: OE "NTSH Ekoinvest & LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S", kurse OE ankues në ofertë ka dorëzuar edhe katalogun me përshkrim teknik të **Dot-Peen Marker, modeli ES 350 ER** të prodhuesit Mannesman. Në katalogun është dhënë përshkrimi i modelit të markerit Dot-Peen i cili vendoset në Stamp Marker Station. Më tej, OE ankues shton se deklarata mbi specifikimet teknike për mallin e ofruar e cila përputhet me atë që përmendet në Aneksin 1 të dosjes së tenderit – Seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), neni 3.1, është e nënshkruar dhe e vulosur nga ana e bartësit të konsorciumit OE N.T.SH. "EKOINVEST" - Prishtinë si dhe nga ana e prodhuesit LOY-MAK MAKINA SAN VE TIC A.S, i cili është edhe anëtar i konsorciumit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se prodhuesit botëror të makinave CNC për prerje, përveç makinave me karakteristika standarde, kryesisht furnizojnë me makina sipas kërkesave të blerësve, në kuptimin e:

- gjerësisë dhe gjatësisë së makinës (aty ku nuk ekziston kufizimi sa i përket gjatësisë).
- saktësisë së kërkuar të prerjes
- procesit të prerjes me plazmë dhe/ose me gas
- sistemit shtytës
- shpejtësisë së pozicionimit
- njësisë kontrolluese- menaxhimi CNC
- plazmës së agregatit
- CAD/CAM-it të softuerit
- konzolës së operatorit për stacionin e aparatit për djegie
- sistemit të konsolës për kontrollin e plazmës THC
- sistemit të konsolës për kokën e plazmës 3D

Pra, në bazë të sqarime të ekspertit teknik në ekspertizën, Paneli Shqyrtues sqaron se është e pamundur për prodhuesit të makinave portale CNC për prerje të paraqesin në katalog çdo detal apo pjesë të imët të pajisjes kur merret parasysh fakti se këto makina prodhohen sipas kërkesave të blerësve, kështu që këto makina nuk

gjenden në stok të prodhuesit. Në bazë të asaj që është cekur si më lartë, makina portale CNC e ofruar ng OE ankues, plotëson të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues të vendosura në dosjen e tenderit – Aneks nr. 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion dhe në sqarimet ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë n kundërshtim me nenin 62 të LPP-së për shkak se asnjëri prej kritereve të përcaktuara në nenin 62 të LPP së nuk janë plotësuar për ta anuluar këtë aktivitet të prokurimit. Përkundrazi, OE ankues i ka plotësua kërkesat e përcaktuara të autoritetit kontraktues në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Anda obligohet autoriteti kontraktues që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë konform neni 59 të LPP-së, duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Ne vende që Autoriteti Kontraktues brenda një afati sa me të shkurte të mundshëm ta zbatoj vendimin e Panelit Shqyrtues , PSH. nr. 61/20 i datës 26.02.2020 dhe të na shpërblej me kontrate, e vonon procesin e Ri vlerësimit të ofertave për 70 dite dhe në kundërshtim te plote me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik dhe vendimin e Panelit Shqyrtues , PSH. nr. 61/20 të datës 26.02.2020 merre vendim prape për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Shkeljet e nenit 1, nenit 6 të LPP dhe nenit 41.2 të RRUOPP;

- Ofertat janë hapur me datën 18.03.2019. **Vlerësimi i pare** i ofertave ka zgjate prej datës 18.03.2019 deri me datën 07.05.2019, gjithsej **40 dite;**
- Kërkesa jone për Rishqyrtim është aprovuar nga Autoriteti Kontraktues si e bazuar me datën 16.05.2019. **Vlerësimi i dyte** i ofertave pas aprovimit te Kërkesës tone për rishqyrtim ka zgjatur prej datës 16.05.2019 deri me datën 09.08.2019, gjithsej **96 dite;**
- Vendimi i pare i Organit Shqyrtues për Ri-vlerësim te ofertave nr. **PSH Nr. 678-698/19** është publikuar me datën 22.11.2019. Vlerësimi i trete i ofertave ka zgjate prej datës 22.11.2019 deri me datën 14.01.2020, gjithsej **54 dite:**
- Vendimi i dyte i Organit Shqyrtues për Ri-vlerësim te ofertave **nr. 61/20** është publikuar me datën 26.02.2020. Vlerësimi i katërt i ofertave ka zgjate prej datës 26.02.2020 deri me datën 08.05.2020, gjithsej **70 dite.**

Bazuar në të dhënat e specifikuara shihet së Autoritet Kontraktues gjate vlerësimit dhe rivlerësimit të ofertave çdo here ka bere shkelje substanciale të nenit 41.2 - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik- A01. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues me ketë neglizhence dhe jo efikasitet të treguar gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bere shkelje substanciale të nenit 1 te LPP- Qëllimi dhe nenit 6 të LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti. Si ka mundësi që për me tepër se 14 muaj nga hapja e ofertave Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur që ta përfundoj me sukses ketë aktivitet të prokurimit. A mbajnë përgjegjësi Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues për këto vonesa të shkaktuara me qellim dhe për kostot shtese që ju kane shkaktuar Operatoreve Ekonomik sa here qe kane kërkuar vazhdimin e Sigurisë së Tenderit?

Nga të dhënat e specifikuara me larte shihet së Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe Ri- vlerësimit të ofertave sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues , PSH. Nr. 61/20 i datës 26.02.2020, dhe marrjes së vendimit për anulimin të aktivitetit të prokurimit, ka bere me shkelje substanciale të nenit 1, 6, 59 dhe 62 të LPP dhe nenit 41.2 të RRUOPP AO1.

Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me larte , kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së që kërkesa jonë të vendoset si qeshtje e gjykuar dhe në tërësi si e bazuar dhe lënda të kthehet në Ri – vlerësim, ndersa ndaj AK KEK te merren masa per mos-respektim te vendimit te OSHP-se dhe "vleresim" jashte kritereve te percaktuara ne FDT dhe ne dosjen e tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Jemi te dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës shume voluminoze, shpenzimet e vazhdimit te validitetit të garancioneve për Sigurim të ofertës, shpenzimet e përgatitjes së katër kërkesave për Rishqyrtim, përgatitjes së tri Ankesave për OSHP dhe fitimet e pritura

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Njoftimi për kontrate: 31.01.2019
2. Procesverbal i hapjes se ofertave – 18.03.2019
3. Njoftimi për dhënie te kontratës/vendimi i AK : 07.05.2019
4. Njoftimi për OE te pasuksesshëm: 07.05.2019
5. Kërkesë për Ri-shqyrtim 13.05.2019
6. Njoftimi për dhënie te kontratës/vendimi i AK : 09.08.2019
7. Njoftimi për OE te suksesshëm: 09.08.2019
8. Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit/vendimi i AK : 25.09.2019
9. Njoftimi për OE te eliminuar: 25.09.2019
10. Kërkesë për Ri-shqyrtim 30.09.2019
11. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim te Kërkesës për Ri-shqyrtim: 02.10.2019
12. Ankesa për OSHP- 10.10.2019
13. Ekspertiza e Eksperteve Shqyrtues: 678-698/19 e datës 28.10.2019
14. Vendimi i PSH Nr. 678-698/19 i datës 22.11.2019
15. Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit/vendimi i AK : 14.01.2020
16. Njoftimi për OE te eliminuar: 14.01.2020
17. Kërkesë për Ri-shqyrtim: 20.01.2020
18. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim te Kërkesës për Ri-shqyrtim: 22.01.2020
19. Ankesa për OSHP- 24.01.2020
20. Ekspertiza e Eksperteve Shqyrtues: 61/20 e datës 12.02.2020
21. Vendimi i PSH Nr. 61/20 i datës 26.02.2020
22. Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit/vendimi i AK : 08.05.2020
23. Njoftimi për OE te eliminuar: 08.05.2020
24. Kërkesë për Ri-shqyrtim 13.05.2020
25. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim te Kërkesës për Ri-shqyrtim:20.05.2020
26. Dëshmitë : 1,2,3,
27. Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se;

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*